



**ANALIZA E MUNGESAVE INSTITUCIONALE TË CILAT E PENGOJNË PUNËN DHE  
AVANCIMIN E EFIKASITETIT TË KOMISIONIT SHTETËROR PËR PARANDALIMIN  
E KORRUPSIONIT**

Autor: Aleksandar N. Pisarev

Nëntor, 2020

## Përmbatja

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE / ABSTRAKTI .....	3
HYRJE .....	4
STRATEGJIA NACIONALE PËR LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT 2020-2024 E PA(MIRATUAR) .....	6
MANGËSITË DHE FORMULIMET E KËQIJA NË DOKUMENTE DHE LIGJE TË RËNDËSISHME.	8
PENGIMI I LIGJIT PËR SINJALIZUESIT .....	10
KONFISKIMI I PRONËS NË PROPORCION TË ZHDREJTË ME NUMRIN E VEPRAVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT .....	11
PERSONELI JO I PLOTË I KSHPK .....	13
(MOS) LIDHJA SOFTUERIKE DHE NDËRMJET RESORËVE .....	14
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME .....	15
LITERATURA E SHFRYTËZUAR .....	18

Ky dokument është përgatitur nga Transparency International (Transparensi interneshënëll) me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë të SHBA-së për zhvillim ndërkombëtar (USAID). Mendimet e shprehura në këtë dokument i takojnë autorit dhe nuk pasqyrojnë qëndrimet e Agjencisë të SHBA-së për zhvillim ndërkombëtar apo Qeverisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE/ABSTRAKTI

Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, siç sygjeron edhe emërtimi i tij, paraqet një trup të specializuar të dedikuar për luftë kundër korrupsionit dhe praktikave korruptuese (apo trup anti-korrupsion). Është themeluar në nëntor të vitit 2020, me miratimin e Ligjit për parandalimin e korrupsionit si shenjë e vullnetit politik për luftë kundër korrupsionit, por edhe si rezultat i aktiviteteve ndërkombëtare të shtetit në atë periudhë. Numri i konventave të nënshkruara dhe ratifikuara si dhe ndryshimet e shumta ligjore në vete nuk paraqesin garancë se ajo që është paraparë në to do të zbatohet në tërësi.

Një grup problemesh që paraqesin frenim respektivisht pengesë dhe kontestojnë punën e Komisionit shtetëror për luftë kundër korrupsionit (KSHPK) është shumë e madhe. Mes atyre që janë më eklatante janë personeli kadrovik i pamjaftueshëm dhe jo përkatës, hapësira e pamjaftueshme dhe jofunksionale për punë e KSHPK, mos lidhja softuerike me institucionet tjera. Ende nuk janë të përcaktuara deri në fund kriteret për prioritetet gjatë ngritjes të procedurës, dhe për këtë shkak nuk mund të procedohet një numër i madh të paraqitjeve respektivisht kallzimeve për korrupsion.

Krahas të gjithë përpjekjeve, nuk është vendosur një sinergji ndërmjet KSHPK, Kuvendit, Qeverisë dhe institucioneve tjera, që tregon se nuk është shprehur vullnet i mjaftueshëm politik për luftë kundër korrupsionit. Është evidente dhe bashkëpunimi i keq ndërmjet KSHPK dhe Prokurorisë Publike (PP) që është një nga pengesat në punën e saj. Ky dokument paraqet përpjekjen që të ngrihet dukshmëria e këtyre problemeve, të tregohet se cilat janë mungesat konkrete dhe të ndihmojmë në punën dhe procedurat në luftën kundër korrupsionit.

## HYRJE

Ky hulumtim është bërë në pritje të miratimit të Strategjisë të re-të vjetër për luftë kundër korrupsionit (me plan veprimi) të cilën duhej që të miratojë Kuvendi që në shkurt të këtij viti. Nga realizimi i saj në shumë segmente do të varet largimi i pengesave të cilat qëndrojnë për momentin në rrugën e KSHPK që të funksionojë më mirë dhe ta zhvillojë më me sukses luftën kundër korrupsionit. Nga këndvështrimi metodologjik, për nevojat e këtij dokumenti është bërë kryesisht i ashtëquajhuri dektop hulumtim (studimi i ligjeve, akteve nënligjore, raporteve dhe të dhënave që janë të disponueshme në ueb-faqen e KSHPK), është shfrytëzuar literaturë vëllimore e teksteve të publikuara dhe hulumtimeve në këtë temë, por edhe intervista, deklaratat, konferenca për shtyp dhe njoftime të KSHPK.

Korniza ligjore nacionale, në të cilën për herë të parë është paraparë Ligji për parandalimin e korrupsionit përmban një numër të madh të dispozitave për avancimin e luftës kundër korrupsionit dhe ndalimin e tij. KSHPK është themeluar në nëntor të vitit 2002, me miratimin e Ligjit për parandalimin e korrupsionit si shenjë e vullnetit politik për luftë kundër korrupsionit, por edhe si rezultat i aktiviteteve ndërkombëtare të shtetit në këtë periudhë. Me miratimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave në vitin 2007 janë dhënë kompetenca të reja për KSHPK në drejtim të të vepruarit në raste dhe ndërmarrjen e masave për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e pushtetit dhe autorizimeve të dhëna publike nga ana e personave zyrtarë.

Edhe pse të dy ligjet janë ndryshuar dhe plotësuar disa herë deri në vitin 2018 për shkak të përforcimit të pozitës të KSHPK, me zbatimin e tyre megjithatë nuk janë arritur efektet e pritura. Për këtë arsye në janar të vitit 2019, është miratuar Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, me të cilin Ligji i deriatëhershëm për parandalimin e korrupsionit dhe Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave janë bashkuar dhe janë përforcuar kompetencat e KSHPK.<sup>1</sup>

Komisioni shtetërorë për parandalimin e korrupsionit, siç sygjeron dhe emërtimi i tij, paraqet një trup të specializuar të dedikuar për luftën kundër korrupsionit dhe praktikave korruptuese.

Ligji i ri për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave i cili ishte miratuar në fillim të vitit 2019 përveç se ka rritur dhe përforcuar kompetencat e KSHPK, ka siguruar edhe mekanizma më efektive për veprim, me çrast janë rritur edhe pritshmëritë e qytetarëve për parandalimin më efikas dhe luftën kundër korrupsionit. Kjo ka rezultuar edhe me rritje të numrit të paraqitjeve të pranuara dhe lëndëve të hapuara në raport me pesë vitet e fundit, është përforcuar integriteti i KSHPK dhe është rritur besimi te qytetarët në këtë institucion, kurse vlerësimet pozitive kanë ardhur edhe nga bashkësia ndërkombëtare. Në vitin 2000 Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV) është bërë anëtare e GREKOS ([Grupi i shteteve kundër korrupsionit](#)) që ka për qëllim të promovojë zhvillimin dhe ndryshimin e politikave dhe iniciativave antikorrupsion por edhe të ndjekë zbatimin e tyre në vendet anëtare.

---

<sup>1</sup> „Gazeta zyrtare e RMV “ nr.12, 19.01.2019

Përparim domethënës i Republikës të Maqedonisë të Veriut në luftën kundër korrupsionit është shënuar në raportin më të ri të Trupit të Këshillit të Europës që merret me monitorimin e standardeve antikorrupsion në shtete – GREKO. Me këtë, shteti jonë ka bërë një hap të madh duke braktisur grupin e shteteve “globalisht të pakënaqshme” dhe ka ecur drejtë përmbushjes të rekomandimeve të GREKO nga rrethi i pestë i vlerësimit. Për zëvendës kryeministrin përgjegjës për luftën kundër korrupsionit dhe krimin, zhvillimit të qëndrueshëm dhe burimeve njerëzore, Ljupço Nikollovski, ky përparim paraqet një stimulim shtesë dhe nxitje në përkushtimet e Qeverisë për ndërtimin e standardeve dhe parimeve për parandalim të korrupsionit në të gjithë fushat.

Bëhet fjalë për 19 rekomandime për parandalim në pjesën e korrupsionit në Kuvend, gjyqësor dhe prokurori, prej të cilave vendi nuk ka përmbushur vetëm dy. Janë përmbushur në tërësi nëntë rekomandime, kurse pjesërisht tetë rekomandime. Sipas ministrit të drejtësisë Bojan Mariçiç, tani Maqedonia e Veriut është një hap më afër BE-së, por megjithatë puna nuk përfundon këtu dhe ka shumë punë për të bërë.<sup>2</sup> Kjo tregon se numri i konventave të nënshkuara dhe të ratifikuara si dhe shumë ndryshime ligjore në vete nuk paraqesin garancë se ajo që është paraparë në to do të zbatohet në tërësi. KSHPK ende ka probleme organizative, kadrovike, institucionale dhe hapësinore të cilat paraqesin një pengesë që me më shumë energji të përfshihet në luftë kundër korrupsionit dhe të ushrojë me sukses funksionin e saj. Kjo rezulton në ngadalësim të punës të tij, procedura të penguar respektivisht bllokuara dhe ende një numër relativisht i vogël i lëndëve të hapura në të cilat është evident korrupsioni. Procedurat për marrjen e të dhënave nga institucionet janë të ngadalshme dhe shumë administrative. Nuk janë të sqaruara deri në fund detyrimet reth procedurës administrative. Institucionet shumë shpesh nuk ofrojnë një bashkëpunim të mjaftueshëm që të ndihmojnë në punën e KSHPK, nuk dorëzojnë në kohë apo aspak nuk dorëzojnë të dhëna dhe dokumente të nevojshme për lëndët e caktuara të cilat janë në procedurë në Komision e për këtë arsye të punësuarit në Komision janë të detyruar që të ushrojnë punën e tyre me çrast humbet efikasiteti. Mungojnë ekspertë për fusha të caktuara të cilët do të ndihmonin gjatë përpunimit profesional të paraqitjeve respektivisht kallzimeve.

Krahas të gjithë përpjekjeve nuk është vendosur një sinergji ndërmjet KSHPK, Kuvendit, Qeverisë dhe institucioneve tjera, që tregon se nuk është shprehur vullneti i mjaftueshëm politik në luftën kundër korrupsionit. Ka shumë probleme të cilët paraqesin pengesë dhe të cilët konstestojnë punën e Komisionit shtetëror për luftë kundër korrupsionit. Mes atyre që janë më eklektante janë personeli kadrovik i pamjaftueshëm dhe jopërkates, hapësira e pamjaftueshme dhe jo funksionale për punën dhe lidhjen softuerike me institucionet tjera. Nuk janë të vërtetuara deri në fund kriteret për prioritetet gjatë ngritjes të procedurës me çrast një numër i madh i paraqitjeve për korrupsion nuk mund të procedohen. Mund të dyshojmë hapur se ka mungesë të vullnetit politik dhe mosrespektim të qëllimshëm të ligjeve të miratuara e kjo e stimulon korrupsionin. Është evident edhe bashkëpunimi i keq ndërmjet KSHP dhe Prokurorisë Publike që është një nga pengesat në punën e saj.

---

<sup>2</sup> Njoftim i KSHPK nga takimi i mbajtur me ministrin e drejtësisë, z.Bojan Mariçiç, të mbajtur në 1 tetor të vitit 2020

Ky dokument paraqet përpjekjen për të ngritur dukshmërinë e këtyre problemeve që të tregohet në mungesa konkrete dhe të ndihmohet në përmirësimin e punës dhe procedurave në luftën kundër korrupsionit.

## STRATEGJIA NACIONALE PËR LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT 2020-2024 E PA(MIRATUAR)

Strategjia nacionale për luftën kundër korrupsionit 2020-2024 që nuk është miratuar ende me të cilën deputetët do të konfirmonin vullnetin e tyre politik për luftë kundër korrupsionit është një nga pengesat për punën e KSHPK. Ky dokument i rëndësishëm është dorëzuar në Kuvendin e Republikës të Maqedonisë së Veriut para një viti megjithatë për shkak të rrethanave të njohura dhe shpërbërjes të Kuvendit për shkak të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, kjo nuk është vendosur në rendin e ditës dhe deputetët nuk kanë zhvilluar debat respektivisht nuk e kanë shqyrtuar këtë dokument. Strategjia në këtë moment nuk zbatohet dhe ky është një problemet akute në luftën kundër korrupsionit. Me këtë kapitull duam të tregojmë problemet dhe dilemat e zbatimit të saj. KSHPK sipas ligjit kishte detyrim që të dorëzojë në Kuvend Strategjinë për luftë kundër korrupsionit me plan aksionar për realizimin e saj 2016-2019, (2020-2024). Këtë detyrim KSHPK e ka përbushur në kohë, por për shkak të shumë rrethanave dhe zgjedhjeve të parakohshme, Kuvendi nuk ka treguar vullnet politik të mjaftueshëm dhe interes që kjo strategji si dokument i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit të ndodhet në rendin e ditës. Me këtë është humbur edhe një vit në të cilin, ajo si pjesë e luftës të përgjithshme kundër korrupsionit, duhej që të realizohej. KSHPK shumë herë, me shkrim dhe përmes komunikimit personal me shërbimet kompetente i është drejtuar Kuvendit dhe ka kërkuar sygjërim dhe përgjigje se si të veprohet më tutje në lidhje me Strategjinë nacionale për luftë kundër korrupsionit.<sup>3</sup>

„Në lidhje me Strategjinë nacionale, kemi marrë përgjigje nga Kuvendi i RMV në të cilën na njoftojnë se në pajtim me nenin 178 të Rregullores për punë të Kuvendit, me skadimin e mandatit të përbërjes të Kuvendit përfundojnë të gjithë procedurat ligjvënëse dhe procedurat për miratimin e akteve tjera të filluara në periudhën mandatuese. Kjo do të thotë se duhet që sërish të dorëzojmë Strategjinë, por megjithatë pasiqë të bëjmë korrigjimet e domosdoshme.<sup>4</sup> Në ndërkohë Platforma e organizatave qytetare për luftë kundër korrupsionit në bashkëpunim me KSHPK në disa takime ka përfunduar bashkarisht se është e nevojshme që të bëhet revizioni respektivisht rishikimi i këtij dokumenti dhe të propozohen ndryshime dhe plotësime eventuale. Ekipi i Platformës pas analizës të detajuar të Strategjisë dhe planit të veprimit ka propozuar disa korrigjime, ndryshime dhe plotësime të dy dokumenteve të cilat do të kontribuonin në përmirësimin e tyre dhe efikasitetin më të madh në luftën kundër korrupsionit. Por, janë hapur shumë dilema për atë se si duhet të qasemi në procesin e miratimit të strategjisë të re/të vjetër 2020-2024. Platforma ka shumë intervenime në dokumentet ekzistuese, fillimisht në Strategji, ndërsa te plani aksionar propozimet për ndryshime dhe plotësime janë më shumë të karakterit

<sup>3</sup> Intervistë me kryetaren e KSHPK, Biljana Ivanovska në datë 8.10.2020

<sup>4</sup> Përgjigje e krytares të KSHPK, Biljana Ivanovska në datë 9.11.2020 në pyetjen e dërguar për nevojat e këtij hulumtimi

teknik. Dilema ishte nëse Komisioni para Kuvendit të dal me një dokument tërësisht të ri që në procedurë parlamentare mund të marr sërish shumë kohë deri te miratimi i tij, që do të ishte pengesë për punën e KSHPK, apo të propozojë ndryshime dhe plotësime të dokumentit ekzistues i cili ndodhet në Kuvend, por si Strategji nacionale për luftë kundër korrupsionit 2020-2024 me Plan të veprimit. Dilemën e ka zgjidhur njoftimi i fundit me shkrim nga shërbimet e Kuvendit deri te KSHPK me të cilin tregohet se procedurat e filluara në mandatin paraprak janë të pavlefshme dhe se duhet të inicohet procedure e re.<sup>5</sup> Komisioni shtetërorë është në mëdysheje, dhe mes vetë anëtarëve ekzistojnë mëdysgje se si të veprohet më tutje. A t'i dorëzohet Kuvendit Strategji e vjetër me rishikime të vogla, apo të qaset drejtë përgatitjes të një dokumenti tërësisht të ri duke marrë parasysh sygjerimet dhe korrigjimet të cilat në dokumentin ekzistues i ka bërë Platforma e organizatave qytetare për luftë kundër korrupsionit, të cilat sipas vëllimit dhe përmbajtjes janë të rëndësishme. Përgatitja e dokumentit tërësisht të ri gjithsesi se do të nënkuptojë që para miratimit të tij në KSHPK dhe para dorëzimit në Kuvend, të ketë debat të gjërë publik, konsultime dhe mendime nga ekspertët dhe sektori civil. Metodologjia e tillë për përgatitjen e strategjisë tërësisht të re (apo rishikimin e Strategjisë të vjetër sërish do të marrë një periudhë të madhe kohore dhe shterje të kapaciteteve të KSHPK, para se ajo të kalojë në procedurë parlamentare. Është e dukshme se do të nevojiten konsultime shtesë para se të dorëzohet një dokument sa më cilësorë që mundet deri te Kuvendi. Është e pritshme që KSHPK do të harmonizojë qëndrimet në një nga seancat dhe të marr vendim se çfarë do të duhej të bëhej me Strategjinë. Duhet të bëhet një përgatitje serioze, me çrast do të vijonte procesi i ndryshimit dhe plotësimit të saj me propozime dhe sygjerime nga ekspertët, nga Platforma dhe palët tjera të interesuara dhe një dokument tërësisht i ri të dorëzohet në Kuvend me kërkesë që ta vendoset në rend të ditës para deputetëve. Me këtë edhe deputetët e Kuvendit do të konfirmonin vullnetin politik për zbatimin e saj.

Të përkujtojmë, Stragjia nacionale për luftë kundër korrupsionit si dokument i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, bashkë me planin aksionar respektivisht të veprimit është detyrim i Komisionit shtetëror për luftë kundër korrupsionit. Komisioni ka përmbushur këtë detyrim dhe si dokument e ka dorëzuar në Kuvendin e Republikës të Maqedonisë së Veriut, por për shkak të rethanave tashmë të thëna, ajo nuk është vendosur në rendin e dtiës para deputetëve me çrast nuk është realizuar edhe shqyrtimi për këtë dokument.

### *Pse është e rëndësishme Strategjia*

Miratimi i Strategjisë nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave është kompetenca e parë dhe jashtëzakonisht e rëndësishme që KSHPK duhej ta realizonte deri në fund të vitit 2019, por vetë fakti se për herë të parë këtë strategji e miraton Kuvendi i RMV-së, e rrit rëndësinë dhe detyrimin për zbatim dhe flet për gatishmërinë dhe vendosshmërinë e shtetit për përforcimin e parandalimit dhe luftën kundër korrupsionit dhe përfshirjes të të gjithë subjekteve të sistemit. Aktivitetet për përgatitjen e strategjisë nacionale kanë filluar që nga gushti i vitit 2008 dhe janë realizuar në disa faza duke përfshirë<sup>6</sup>: Vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni në të cilën është përgatitur “Metodologjia për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni” si bazë për vlerësimin e fushave të rrezikuara, institucioneve apo ligjeve të cilat në masë më të madhe gjenerojnë korrupsion në shpenzimin e parave publike apo keqpërdorim të pozitave zyrtare në

<sup>5</sup> Përgjigje nga Shërbimi i Kuvendit deri te KSHPK.

sektorin publik. Është përfshirë edhe përkufizimi i problemeve që janë të prirur respektivisht i nënshtrohen sjelljes korruptuese të cilat rrjedhin nga rregullativa ligjore e paqartë apo e paharmonizuar, përplasja apo mosdhënia e kompetencave apo kapaciteteve të dobëta institucionale. Të gjithë këto aktivitete janë inkorporuar në Strategjinë nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave 2020-2024 dhe plani i veprimit. Ndaj përgatitjes të këtij dokumenti është qasur me seriozitet të plotë, kurse në përgatitjen e tij kanë marrë pjesë përfaqësues të shumë institucioneve relevante, sektori civil, mediat, ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë. Janë mbajtur më shumë punëtori dhe janë përkufizuar shumë probleme të cilat gjenerojnë sjellje korruptuese, e të cilat rrjedhin nga rregullativa ligjore e paqartë apo e paharmonizuar, përplasja apo mosdhënia e kompetencave, kapacitetet e dobëta institucionale, instrumente të dobëta apo që aspak ekzistuese për sanksionim. Plan i veprimit përfshin masa dhe aktivitete, afate kohore dhe institucione të cilat do të jenë të detyruara për zbatimin e tyre.

## MANGËSITË DHE FORMULIMET E KËQIJA NË DOKUMENTE DHE LIGJE TË RËNDËSISHME

KSHPK ka disa kompetenca<sup>7</sup> të ndjek zgjedhjet, të cilat rrjedhin nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave (LPKKI), Kodi zgjedhor, por edhe aktet tjera. Analiza e këtyre akteve tregon se ekzistojnë shumë paqartësi në dispozitat e tyre, dhe kjo mund të ngadalësojë në mënyrë të konsiderueshme punën e Komisionit, respektivisht të sjellë deri te rënia e cilësisë në punën e saj. Megjithatë, në ligje ka edhe risi që janë qartësisht pozitive për legjislacionin maqedonas. Këtu do të përqipemi që të tregojmë disa dispozita ligjore nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe Kodi zgjedhor të cilat paraqesin pengesë për funksionimin e mirë të KSHPK dhe ofrojnë “zbrazëtira” të cilat në situata të caktuara mund të keqpërdoren nga partitë politike duke shmangur Ligjin. LPKKI, në fakt, kreu i katërt përkushtohet në parandalimin e korrupsionit në politikë. Në këtë pjesë janë stimuluar një pjesë e aktiviteteve të Komisionit gjatë procesit zgjedhor. Në nenin 31 parashihet se Komisioni mundet me iniciativë personale (që do të thotë *sipas dyshimit personal*) apo me propozim të organeve shtetërore, partive politike, shoqatave apo fondacioneve që punojnë në fushën e parandalimit të korrupsionit, sundimit të ligjit apo qeverisjes të mirë të marrë **aktvendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e financimit të partive politike**. Sipas nenit 31, KSHPK e parashtron **aktvendimin** për fillimin e procedurës deri te partia politike për përgjigje (në afat prej 15 ditësh) kurse ka detyrim që në afat prej 60 ditësh të përfundojë procedurën e shqyrtimit. Nëse vërteton shkelje, KSHPK kërkon që të veprojnë organe të tjera kompetente, respektivisht nuk mund të sanksionojë vetë. Vetë formulimi në Ligj- *aktvendim, ka vendosur* është jo përkatës dhe problematik dhe paraqet pengesë për punën efikase të komisionit.<sup>8</sup> Formulimi i tillë i mundëson partisë politike që të ngrejë procedurë kundër KSHPK para gjykatës administrative, edhepse Komisioni nuk ka konstatuar ende ndonjë shkelje të Ligjit, por vetëm **ka vendosur** që të inicojë

<sup>6</sup> Burimi: KSHPK

<sup>7</sup> „Gazeta zyrtare e RMV “. nr.12. 19.01.2019, neni 17



procedurë.

Ligjvënësi nuk ka paraparë, se *aktvendimi* është akt ligjor dhe se në atë rast duhet që partisë politike t'i jepet mundësia të ketë mbrojtje juridike apo mjet juridik (*ankesë deri te instanca më e lartë apo padi në Gjykatën administrative*). *Mbrojtja juridike apo mjete juridik rrjedhin nga Ligji për procedurën e përgjithshme administrative i cili zbatohet edhe në procedurat të cilat i zhvillon KSHPK.*

Ndërsa në rastin konkret, është tërësisht jologjike që partia politike të ketë në dispozicion mjetin juridik kundër *aktvendimit për inicimin e procedurës për shqyrtim* sepse me këtë aktvendim KSHPK ende nuk ka vendosur asgjë dhe është logjike që të mos mund të parashtrijë ankesë për diçka që nuk është vendosur, respektivisht vetëm ka inicuar procedurën. Nëse vërteton shkelje, KSHPK kërkon që të veprojnë organet tjera kompetente, respektivisht nuk mund të sanksionojë vetë. Megjithatë, vetë formulimi hap hapësirë të mjaftueshme për partitë politike, të këshilluara nga juristët e aftë, që të vonojnë procedurat përmes formaliteteve.<sup>9</sup> Për këtë arsye, është e detyrueshme që të ndryshohet formulimi, në këtë dhe në të gjithë nenet tjera ku ekzistojnë gjëra të tilla jologjike. Në LPKKI duhet vetëm të përmendet se në rast të dyshimit, *KSHPK inicon procedurë për shqyrtim* (pa marrë aktvendim). Respektivisht, nëse eliminohet formulimi *aktvendim*, do të shmanget rreziku që partia politike të trajtojë si akt administrativ për të cilin sipas ligjit do të duhet të parashihet mjeti juridik, respektivisht e drejta në ankesë. Në atë rast, si momenti i fillimit të procedurës do të merret ai moment kur partia politike është njoftuar se kundër saj është ngritur procedurë. Dhe jo se është njoftuar dhe është marrë *aktvendim* për fillimin e procedurës që do të trajtohej si akt administrativ.<sup>10</sup> Kjo tregon qartë se sa një formulim mund të pengojë punën e KSHPK dhe të jetë pengesë që ky institucion të ndjek ligjshmërinë në financimin e fushatave zgjedhore.

Në një pjesë të publikut, sidomos në pjesën e qarqeve shkencore<sup>11</sup> ekziston mendimi se aktet që KSHPK i merr gjatë veprimit të saj janë akte administrative, që udhëzon në zbatimin e plotë të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA). Baza për mendimin e tillë rrjedh nga neni 22 paragrafi 1 i LPKKI ku është përcaktuar se KSHPK në seancat a saj merr *aktvendime*. Identifikimi i fjalës “**aktvendim**” si sinonim të aktit me të cilin përfundon çdo veprim i KSHPK me “**akt administrativ**” është vërtetuar si problem serioz dhe pengesë në efikasitetin e punës të Komisionit. Duke marrë parasysh kompetencat e KSHPK që të ngrejë iniciativa para organit kompetent, zbatimi i dispozitave të LPPA në çdo veprim të KSHPK mund të pengojnë seriozisht funksionimin e KSHPK dhe të sjellë në pyetje ekzistimin e funksionit të saj. . Rrjedhimisht, është e detyrueshme që të precizohet nocioni “aktvendim” si sinonim i aktit me të cilin përfundohet çdo veprim i Komisionit, por edhe të parashihet mundësia që komisioni të jap rekomandime, udhëzime, mendime, të cilat nuk do të jenë thelbësisht të detyrueshme, por do të ndikojnë seriozisht në veprimin e ardhshëm të subjekteve në system.

<sup>8</sup> Bitrakov, Konstantin. Analizë: „Методологија и инструменти на ДКСК во пресрет на изборите“, Скопје, 2020, стр. 14, <https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2020/04/Analiza.pdf>


<sup>9</sup> Po aty fq. 15-16

<sup>10</sup> Po aty fq. 16

<sup>11</sup> Po aty fq. 16

## PENGIMI I LIGJIT PËR SINJALIZUESIT

Zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve<sup>12</sup> ende nuk është në nivel të kënaqshëm, dhe është kryesisht për shkak të mungesës të vullnetit politik për vendosjen e një sistemi efikas për mbrojtjen e sinjalizuesve në institucionet e sektorit publik. Deri në fund të vitit të kaluar në regjistrin e personave të autorizuar për pranimin e paraqitjeve nga sinjalizues janë evidentuar 105 institucione të sektorit publik të cilët kanë paraqitur 107 persona të autorizuar për pranimin e paraqitjeve respektivisht kallzimeve nga sinjalizuesit (në dy institucione janë zgjedhur nga dy persona). Duke krahasuar këto të dhëna me numrin e përgjithshëm të institucioneve aktive të karakterit publik të cilët sipas të dhënave nga viti 2019 janë 1324, mund të konstatohet se vetëm 8 përqind prej tyre kanë përmbushur detyrimin për dorëzimin e Njoftimit për personin e autorizuar dhe të dhënat e tij të kontaktit në KSHPK. Nga këqyrja në faqen e internetit të institucioneve është vërejtur se një pjesë e tyre kanë vepruar sipas Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe kanë vendosur sistemin e mbrojtur të paraqitjes të brendshme, por nuk kanë përmbushur detyrimin për parashtrimin e raporteve ndaj KSHPK.<sup>13</sup>



Institucionet janë të detyruara që dy herë në vjet të parashtrajnë në KSHPK (në janar – për gjysëmvetor) raport për paraqitje të pranuar nga sinjalizuesit. Këto të dhëna për vitin 2019 do të paraqiten në Raportin për KSHPK për vitin 2020. Në vitin 2018 nga 1324 institucionet publike të përmendura, këtë detyrim e kanë përmbushur vetëm 52. Këtë detyrim ndaj KSHPK nuk e kanë përmbushur institucionet si Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Prokuroritë Publike kompetente, Avokati i Popullit i RMV dhe institucionet tjera, kurse nga sektori privat vetëm 10 (sektori privat nuk është i detyruar që të parashtrjë raporte të këtij lloji).

<sup>12</sup> Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, „Gazeta Zyrtare e RM-së “ nr. 196. 10.11.2015

<sup>13</sup> Raporti vjetor për punën e KSHPK për vitin 2019, fq. 45.

[https://dksk.mk/fileadmin/user\\_upload/2020/Godishen\\_izveshta\\_\\_\\_za\\_rabotata\\_na\\_DKSK\\_-\\_2019.pdf](https://dksk.mk/fileadmin/user_upload/2020/Godishen_izveshta___za_rabotata_na_DKSK_-_2019.pdf)

Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve është një nga instrumentet e fundit të cilin e ka fituar Maqedonia në luftën kundër korrupsionit – shumë pritshmëri pak rezultate. Ligji është miratuar në nëntor të vitit 2015 si rezultat i të ashtq. Marrëveshje e Përzhinës, në të cilin janë inkorporuar standardet më të larta ndërkombëtare të bazuara në praktikën ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, pa ndonjë shqyrtim publik më të gjatë, as nga ana e të gjithë aktorëve të përfshirë, as prej tyre të cilëve u imponohen detyrime, Kuvendi i Republikës të Maqedonisë e ka miratuar Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe i njëjti është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës të Maqedonisë nr.196 të vitit 10.11.2015.

Komisioni i Venedikut dhe Raporti i progresit për Maqedoninë e Veriut për vitin 2016 të Komisionit European tregojnë se nevojitet përgatitje e konsiderueshme ligjore, institucionale dhe praktike për zbatimin efektiv të Ligjit. Kuvendi ka pranuar syzjerimet, kurse me ndryshimet mundësohet mbrojtja më e madhe e sinjalizuesve dhe mes të tjerave sigurohet një institucion (KSHPK) që kryen mbikëqyrje mbi zbatimin e ligjit. Por, njohësit e kësaj problematike thonë se, sipas direktivave më të reja europiane, kjo nuk është e mjaftueshme.

Magjistrin e shkencave juridike Bojan Georgievski, vlersëson se ekzistojnë disa gjëra të cilat duhet të përmirësohen në Ligj. Nevojitet mbrojtje shtesë që do të inkurajojë sinjalizuesit që të paraqesin korrupsionin apo kriminalitetin apo veprimet tjera të cilat dëmtojnë interesin publik. Sinjalizuesit duhet të gëzojnë mbrojtje gjyqësore dhe mbrojtje të integritetit.

Ka edhe një kontradiktë në Ligjin maqedonas dhe në lidhje me atë që parasheh direktiva europiane. Kanalet e paraqitjes, të cilat janë nga rradhët e institucioneve shtetërore, kurse në udhëzimet europiane ata duhet të jenë në institucionet shtetërore, por të ndara në aspekt financiar dhe strukturor prej tyre. Propozim-direktiva europiane parasheh që kanalet për paraqitje që janë pjesë e vetë institucionit të jenë vendosur në vetë institucionin, por të jenë në aspekt financiar dhe strukturor të pavarura që të mos i nënshtrohen ndikimit nga shtetit apo nga disa institucione.<sup>14</sup>

## KONFISKIMI I PRONËS NË PROPORCION TË ZHDREJTË ME NUMRIN E VEPRAVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT

Konfiskimi i pronës të fituar në mënyrë të kundërligjshme si një nga masat që mund të dekurajojë korrupsionin në nivel të lartë që nuk zbatohet proporcionalisht me numrin e veprave për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Kjo paraqet një nga elementet që konteston dhe pengon luftën kundër korrupsionit. Është

---

<sup>14</sup> Intervistë me m-r Bojan Georgievski, e mbajtur në datë 2 nëntor të vitit 2020

evidentuar mungesa e masës të konfiskimit si në formën e tij themelore, ashtu edhe në formatin e konfiskimit të zgjeruar. Te ne dhe të legjislacioni jonë më së shpeshti gjatë kriminalitetit të tillë, ndiqet kryerësi, kurse prona e tij e fituar në mënyrë të kundërligjshme mbetet “e mbrojtur”, që është një nga elementet e luftës jo efikase të çrrënjosjes të korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe paraqet një nga pengesat për efikasitetin e KSHPK.

„Është e domosdoshme që prokuroria të shfrytëzojë dispozitat në ligj të cilat lejojnë kërkesën dhe shqiptimin e masës të konfiskimit, sidomos që ky lloj i sendeve nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit, janë në masë të madhe sende të cilat janë të përshtatshme për kërkesë dhe aplikim të kësaj mase“.<sup>15</sup>

Zëvendës kryeministri për luftë kundër korrupsionit Ljupço Nikollovski, në një takim në zum me përfaqësuesit e OC në lidhje me këtë pyetje ka deklaruar se Qeveria është e vetëdijshme për nevojën e miratimit të Ligjit për prejardhjen e pronës dhe se insiston që kjo të ndodh.<sup>16</sup> Edhe ministri për drejtësi Bojan Mariçiq gjatë vizitës të KSHPK në bisedë me kryetaren dhe anëtarët e komisionit kundër korrupsionit ka theksuar nevojën e përforcimit të politikave kundër korrupsionit dhe ndryshim eventual të ligjeve në këtë fushë.<sup>17</sup>

Republika e Maqedonisë së Veriut ka ratifikuar konventat ndërkombëtare të cilat i referohen konfiskimit të pronës të përfituar në mënyrë të kundërligjshme, dhe është bërë edhe harmonizimi i legjislacionit nacional me direktivat e Bashkimit Europian të cilat i referohen kësaj fushe. Përveç asaj që shteti edhe më tutje është kritikuar shpesh se nuk përballlet në mënyrë të duhur me korrupsionin, sidomos me të ashtëquajturin korrupsion i lartë që shpeshherë tregohet në gishta sepse bartësit e tij janë politikanët e mëparshëm apo aktual dhe funksionarë të lartë shtetëror. Prandaj edhe qytetarët dhe ekspertët gjithnjë e më shumë e ngrejnë pyetjen për prejardhjen e pronës dhe kërkojnë hetime financiare dhe konfiskim të pronës të përfituar në mënyrë të kundërligjshme. Megjithatë, në Ligj theks më i madh është dhënë marrjes të sendeve me të cilat është kryer vepra penale apo janë rezultat i veprës penale, dhe në këtë aspekt, marrja i referohet kryesisht sendeve të luajtshme dhe në pajtim me të, kjo dispozitë nuk mund të trajtohet si konfiskim i pronës në kuptimin e drejtë të fjalës.<sup>18</sup> Është interesante se edhe në Kodin penal përdoren në mënyrë alternative tre nocione të ndryshme: „konfiskimi“, „konfiskimi/marrja“ dhe „marrja“, pa patur një kufizim të qartë gjatë përdorimit të këtyre nocioneve dhe pa u dhënë përkufizime për këto nocione në nenin 122 në KP.<sup>19</sup>

Edhe pse masa e konfiskimit është paraparë në KP në vitin 2004, aktgjykimet e para në të cilat është shqiptuar kjo masë janë nga viti 2008 dhe kjo është për shkak të procedurës jo tërësisht të qartë të konfiskimit, kapacitetit të ulët dhe resurseve të pamjaftueshme në institucionet e specializuara për zbatimin e hetimit financiar e për këtë arsye konfiskimi si një nga mjetet për luftë kundër

<sup>15</sup> Avramovski, Darko., Petrovska. Natali. Konfiskimi i pronës në procedurat gjyqësore në lidhje me korrupsionin, Shkup 2019. fq.6-8, <http://www.antikorupcija.mk/uploads/records/file/Policy%20brief%20A4T,%20November%202019.pdf>

<sup>16</sup> Takim në zum me përfaqësues të OC në datë 12.11.2020

<sup>17</sup> Njoftim i KSHPK i datës 1.10.2020

<sup>18</sup> Avramovski, Darko., Petrovska. Natali. Konfiskimi i pronës në procedurat gjyqësore në lidhje me korrupsionin. Shkup 2019. fq. 9. <http://www.antikorupcija.mk/uploads/records/file/Policy%20brief%20A4T,%20November%202019.pdf>

<sup>19</sup> Po aty fq. 6

korupsionit ende zbatohet dobët dhe rrallë. Me fjalë të tjera, numri i masave të shqiptuara të konfiskimit është joproportionalisht më i vogël nga numri i personave të dënuar e për këtë shkak shteti ende rradhitet lartë si i korruptuar dhe me ndikime politike mbi gjyqësorin.

## PERSONELI JO I PLOTË I KSHPK

Mënyra e re përfshirëse respektivisht inkluzive dhe transparente e përzgjedhjes të anëtarëve të Komisionit ka rritur pritshmëritë jo vetëm të qytetarëve por edhe të bashkësisë ndërkombëtare për një qasje tërësisht të re dhe mënyrë të punës të KSHPK – profesionalizmi, joselektiviteti në veprim, të qenit të hapur për qytetarin dhe mungesa e ndikimit politik. Me Ligjin për parandalimin e korupsionit dhe konfliktit të interesave janë përcaktuar 29 kompetencat të cilat i ka KSHPK.<sup>20</sup>

Mes të tjerash këtu është edhe zhvillimi i politikave kundër korupsionit respektivisht antikorrupsion dhe përmirësimi i klimës antikorrupsion, që varet drejtëpërdrejtë edhe nga kapacitetet për zgjidhjen e problemeve të cilat janë pengesë për funksionimin e KSHPK. Këtu bën pjesë edhe bashkëpunimi me organet shtetërore që ende nuk është në nivelin e kënaqshëm për të siguruar funksionimin e tij të pandërprerë. Kushtet hapësinore për punë të KSHPK janë mjaftë të këqija, dhe nuk është gjetur zgjidhje. Është shpallur rekonstruktimi dhe adaptimi në hapësirën ekzistuese afariste, po mjetet ende nuk janë siguruar. Nga 51 vendet e parapara të punës janë plotësuar 24, që paraqet 47 përqind të plotësueshmërisë. Nuk është eshtë e përshtatshme edhe gjendja me strukturën udhëheqëse, udhëheqësit e sektorëve, njërive dhe këshilltarëve, sepse nga 15 vende të plotësuara udhëheqëse janë vetëm një e pesta, respektivisht vetëm tre. Duke patur parasysh se me Ligjin për parandalimin e korupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisionit shtetëror i janë dhënë kompetenca të reja, masa dhe mekanizma për zbatimin e tyre, organizimin ekzistues dhe burimet njerëzore të disponueshme, aspak nuk mund të përgjigjen në nevojat për realizim efikas dhe efektiv të kompetencave. Për këtë arsye është përgatitur Plani vjetor për punësim në KSHPK dhe pas marrjes të pëlqimit nga Ministria e Financave, gjatë vitit 2019 përmes dy konkurseve publike janë punësuar gjashtë nëpunës administrativ, respektivisht katër janë punësime të reja, kurse dy persona nga kuadri ekzistues janë avancuar në pozita më të larta të punës.<sup>21</sup>

Megjithatë edhe kjo është një përgatitje e pamjaftueshme kadrovike të institucionit. KSHPK ka dorëzuar Planin për punësim deri te Ministria kompetente, i cili është ndryshuar disa herë. Ministri i drejtësisë Bojan Mariçiq së fundi ka vizituar Komisionin shtetëror për parandalimin e korupsionit<sup>22</sup> ku ka realizuar takim me kryetaren dhe anëtarët e komisionit kundër korupsionit. Në këtë takim është diskutuar edhe reth mundësive për përforcimin e kapaciteteve të Komisionit shtetëror për parandalimin e korupsionit që do të ndihmonte për parandalimin më efikas dhe luftën kundër korupsionit. Në fokus të takimit ishin rekomandimet e GREKo nga Rethi i tretë i

<sup>20</sup> LPKKI, neni 17

<sup>21</sup> Raporti për punën e KSHPK i vitit 2019, fq. 10

<sup>22</sup>Njoftim nga vizita e ministrit Bojan Mariçiq në KSHPK në datë 1.10.2020

vlerësimit, që është në temën “Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit të pushteti qëndror (funksionet më të larta ekzekutive) dhe organet ligjzbatuese “.

„Pas diskutimit të mëparshëm me ministrin Besimi, deri te Ministria e Financave (MF) kemi dorëzuar Planin e ri për punësime me të cilin për gjysëmvetorin e parë të vitit kemi paraparë 8 punësime të reja dhe 7 avancime. Jemi marrë vesh që me rebalancin e Buxhetit për gjysëmvetorin e dytë të vitit të bëjmë ndryshime dhe plotësime të Planit edhe për 8 punësime“.<sup>23</sup>

Megjithatë, për KSHPK ende nuk është siguruar hapësirë e mjaftueshme funksionale për punë. Është planifikuar që ky institucion të transferohet në një hapësirë tërësisht të re, më të madhe dhe më funksionale. Megjithatë për shkak të resurseve të harxhuara të shtetit në luftën me covid 19 këto plane tani për tani janë shtyrë. Një nga zgjidhjet që e propozojnë të punësuarit në KSHPK, e cila në një fare mënyrë përkohësisht do të zgjidhte këtë problem edhe riadaptimi i hapësirës ekzistuese afariste, me formimin e disa zyrave të reja për të punësuarit e rinj të cilat priten në vitin 2021.

Edhe ministri Besimi dhe zëvendës kryeministri Nikollovski gjatë vizitës së fundit në KSHPK kanë shprehur gatishmërinë që ky problem të zgjidhet urgjentisht. “Është ofruar mbështetje për realizimin e disa prej çështjeve të hapura në Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit siç janë sigurimi i hapësirës afariste, si dhe sigurimin e buxhetit të mjaftueshëm për realizimin e kompetencave ligjore të KSHPK në drejtim të përgatitjes të zgjidhjes softuerike për plotësim dhe dorëzim elektronik të formularit për gjendjen pronësore dhe interesat edhe për Regjistrin për personat e zgjedhur dhe të emëruar“.<sup>24</sup>

## MOS(LIDHJA) SOFTUERIKE DHE NDËRMJET RESORËVE

Për punën efikase të KSHPK është e domosdoshme lidhja softuerike dhe ndërmjet resorëve ndërmjet institucioneve të cilat sipas funksionit të tyre janë të përfshira në luftën kundër korrupsionit. Këtu para së gjithash mendohet në Prokurorinë publike, bankat, institucionet të cilat ndjekin rrjedhën e parave dhe luftojnë kundër larjes të parave, respektivisht tridhjetë institucione të tilla me të cilat KSHPK edhe krahas nevojës të domosdoshme, nuk është e lidhur në mënyrë softuerike dhe ndërmjet resorëve. Si pengesë veçanërisht paraqitet bashkëpunimi jofunksional ndërmjet Prokurorisë Publike dhe KSHPK. Ekzistojnë arsye objektive dhe subjektive. Në PP për funksionalitetin e saj efikas duhej të formoheshin qendra hetimore të cilat do të dorëzonin të dhëna për aktakuzën referente për secilin rast, dhe të dhënat e tilla do të dorëzoheshin edhe deri te KSHPK nëse ekzistojnë elemente për korrupsion. Duke patur parasysh se në PP nuk është vendosur një sistem i tillë, PP dhe KSHPK nuk janë të lidhura në mënyrë funksionale, efikasiteti i PP nuk është në nivel të lartë që shpesh interpretohet edhe si opstruksion respektivisht pengesë nga ana e individëve apo grupeve në PP. Për këtë KSHPK, shpesh detyrohet që për raste të caktuara të përpunojë punën e PP e që i merr kohë, energji, dhe i shteron resurset. Duhet që vetë të zbatojë hetimin për rastet e caktuara, në vend se këtë ta bëjë PP. Por,

<sup>23</sup>Nga intervista përmes postës elektronike me Kryetaren e KSHPK në 8 tetor të vitit 2020

<sup>24</sup>Po aty

edhe kur KSHPK do të bëjë punën e tyre dhe do të vijë deri te njohuritë e caktuara të cilat tregojnë në mënyrë evidente për korrupsion dhe kriminalitet dhe do i dorëzojë deri te PP, ajo do të ngrejë aktakuzën që shkon shumë ngadalë apo aspak nuk ndodh, kurse qytetarët fajin e hedhin në KSHPK. Mund të përfundohet, se pengesa kryesore në këtë segment është vendosja e dobët organizative e PP dhe moekzistimi i lidhjes ndërmjet këtyre dy institucioneve, KSHPK dhe PP.<sup>25</sup>

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Procedurat për të dhënat e fituara nga institucionet janë të ngadalshme dhe shumë administrative. Institucionet shpesh nuk tregojnë bashkëpunim të mjaftueshëm që të ndihmojnë në punën e KSHPK, me çrast të punësuarit në Komision janë të detyruar që të kryejnë edhe punën e tyre me çrast humbet efikasiteti. Këto procedura duhet të përshpejtohen dhe të vendoset një bashkëpunim më i mirë ndërmjet resorëve ndërmjet institucioneve.

Krahas të gjithë përpjekjesve, nuk është vendosur sinergji ndërmjet KSHPK, Kuvendit, Qeverisë dhe institucioneve tjera, që tregon në shprehjen e vullnetit të pamjaftueshëm politik për luftë kundër korrupsionit. Nevojitet që të vendose një gjë e tillë.

Në KSHPK mungojnë ekspertë për fusha të caktuara të cilët do të ndihmonin gjatë përpunimit profesional të paraqitjeve. Hapësira e pamjaftueshme dhe jofunksionale për punë, moslidhja softuerike me institucionet tjera dhe problemet tjera janë pengesë në punën e KSHPK. Duhet të plotësohet urgjentisht personeli i KSHPK, të zgjidhen problemet teknike teknologjike, si dhe problemet me hapësirën afariste. Nuk janë të përcaktuara deri në fund kriteret për prioritetet gjatë ngritjes të procedurës për arsye se një numër shumë i madh i paraqitjeve të korrupsionit nuk mund të përpunohen. Nevojitet që sa më herët të miratohen kriteret për prioritetet gjatë ngritjes të procedurave.

Është evidente dhe gjendja e keqe ndërmjet KSHPK dhe Prokurorisë Publike që është një nga pengesat në punën e saj. Nevojitet që të vendoset një bashkëpunim më i mirë ndërmjet këtyre dy institucioneve. Ende nuk është miratuar Strategjia nacionale për luftë kundër korrupsionit. Nevojitet që sa më shpejtë të silllet dhe të miratohet në Kuvend. Vendosja ekzistuese organizative dhe burimet njerëzore të disponueshme nuk mund të përgjigjen në kompetencat e reja të dhëna, në masat dhe mekanizmat për zbatimin e tyre, dhe nevojat për për realizimin efikas dhe efektiv të kompetencave. Nevojitet që të shfrytëzohen të gjithë mundësitë dhe zgjidhjet e disponueshme ligjore për përforcimin e kapaciteteve për Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit që do të ndihmonte për parandalimin më efikas dhe luftën kundër korrupsionit.

---

<sup>25</sup> Po aty

Zbatimi i Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve ende nuk është në nivel të kënaqshëm, dhe kjo është kështu kryesisht për shkak të mungesës të vullnetit politik për vendosjen e sistemit efikas për mbrojtjen e sinjalizuesve në institucione të sektorit publik. Nevojitet që të harmonizohet ky ligj me praktikën ndërkombëtare dhe mbrojtjen shtesë e cila do të inkurajojë sinjalizuesit që të paraqesin korrupsionin apo kriminalitetin apo veprimet tjera të cilat dëmtojnë interesin publik.

Numri i masave të shqiptuara të konfiskimit është joproportionalisht më i vogël nga numri i personave të dënuar e për këtë arsye shteti ende rradhitet lartë si i korruptuar dhe me ndikime politike mbi gjyqësorin. Ekzistojnë më shumë nocionet të ndryshme të cilat përdoren në Ligj: prona e konfiskuar, sendet e marra, prona e marrë përkohësisht, konfiskimi i përhershëm i pronës. Nevojitet që të bëhet harmonizimi i terminologjisë të shfrytëzuar, si dhe të bëhet kufizimi përkatës i konfiskimit dhe marrjes të sendeve të cilat janë dedikuar respektivisht destinuar për kryerjen e veprëve penale apo të cilat rrjedhin nga vepra penale.

Në LPKKI dhe në Kodin zgjedhor ekzistojnë më shumë paqartësi në terminologji dhe dispozitat e tyre, dhe kjo mund të ngadalësojë në mënyrë të konsiderueshme punën e Komisionit, respektivisht të sjell deri te zvogëlimi i cilësisë të punës të tij. Nevojitet që të precizohen nocionet “aktvednim” si sinonime me të cilat përfundohet çdo veprim i Komisionit.



**Profili i autorit:** Aleksandar N.Pisarev, gazetar hulumtues për një kohë të gjatë në „Forum – Qendra për hulumtime strategjike dhe dokumentim”, ka punuar si korrespondent i më shumë mediave të huaja, ka qënë ndihmës për një kohë të gjatë dhe redaktor kryesor i revistës „Forum“, ndihmës redaktor kryesor i revistës “Kapital”. Autor i disa librave nga fusha e zhvillimit të vetëqeverisjes lokale, fitues i çmimeve vendore dhe ndërkombëtare për gazetari hulumtuese.

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Fakiq, Sabina. Rritja e efikasitetit të punës të KSHPK. Qendra për komunikime qytetare Shkup 2020.
2. Avramovski, Darko., Petrovska, Natali. Konfiskimi i pronës në procedura gjyqësore në lidhje me korrupsionin. USAID – Platforma e OC për luftën kundër korrupsionin. Shkup 2019.
3. Битраков Константин. Анализа-методологија и инструменти на ДКСК во пресет на избори. Институтити për demokraci “Societas Civilis”. Shkup 2020.
4. Raporti i KSHPK për vitin 2016 .
5. Raporti në hije për kapitullin 23 për periudhën nga qershori i vitit 2018 dhe marsi i vitit 2019. Институтити për politikë europiane. Shkup 2019.
6. Raport vjetor për punën e KSHPK për vitin 2019. KSHPK Shkup 2019.
7. Игор К. Илиевски, Анализа и истражување на Закон за заштитено пријавување, ТМ. Скопје 2019
8. Programi shtetëror për parandalim dhe represion të korrupsionit dhe parandalimit dhe zvogëlim të konfliktit të interesave me plan të veprimit 2016-2019. KSHPK Shkup 2015.
9. Analiza e të dhënave nga procedurat gjyqësore të vëzhguara nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit në vitin 2019. Koalicioni për gjykimin e drejtë. Shkup 2019.
10. Strategjia nacionale për luftë kundër korrupsionit 2020-2024. KSHPK. Shkup 2018.
11. Тасева, Слаѓана, Нулта толеранција за корупција, ТИМ 2007.